



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

KORNIZA
KURRIKULARE
E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Të dashur nxënës,

Të nderuar mësues, drejtues të shkollave dhe prindër,

Misioni i sistemit arsimor është realizimi i interesave të nxënësve. Zhvillimi me hapa të shpejtë i shoqërisë së dijes, i teknologjisë dhe tregut të punës, kërkojnë përshtatjen me to, të sistemit arsimor, me në qendër nxënësin, me qëllim zotërimin e kompetencave evropiane të domosdoshme për të nxënësit afatgjatë dhe formimin e individit.

Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar shënon një hap të rëndësishëm në procesin e reformimit të arsimit në vendin tonë. Ajo është rezultat i një bashkëpunimi të gjerë dhe i diskutimit me mësues, prindër dhe specialistë të arsimit. Ky dokument bazohet në traditën më të mirë të arsimit tonë kombëtar dhe në prirjet themelore të zhvillimit të arsimit në Evropë dhe më gjerë. Në themel të kësaj kornize qëndrojnë të nxënësit dhe arrijtjet nga të gjithë nxënësit, pavarësisht nga gjendja e tyre sociale apo ekonomike, gjinia, etnia, aftësitë për të nxënë, etj.

Korniza përcakton rezultatet e pritshme të të nxënësit dhe pasqyron vlerat themelore të sistemit tonë arsimor, duke e bërë atë të krahasueshëm me sistemet arsimore të vendeve të zhvilluara. Si e tillë, korniza kurrikulare ka vlerën e një dokumenti bazë e afatgjatë të politikës arsimore.

Zbatimi i kornizës kurrikulare kërkon hartimin e politikave arsimore që sigurojnë baraspeshën ndërmjet interesit të nxënësit si individ dhe kërkesave të sotme e të ardhme të shoqërisë dhe të ekonomisë të mbështetura në dije. Faktori kyç për zbatimin me sukses të kornizës kurrikulare është puna dhe përkushtimi i mësuesve dhe drejtuesve të shkollave.

Shpreh bindjen, se ky dokument themelor i kurrikulës së arsimit parauniversitar do të konsolidojë sistemin tonë arsimor dhe do të përmirësojë cilësinë, si një nga prioritetet kryesore të zhvillimit të arsimit parauniversitar.



Prof. Dr. Myqerem Tafaj
Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Tiranë, 2013

TABELA E LËNDËS

PJESA E PARË

1. Hyrje	7
2. Sistemi arsimor parauniversitar, nevoja për ndryshime kurrikulare	9
3. Sistemi arsimor parauniversitar, synimet dhe rezultatet e pritshme.....	13
4. Parime të përgjithshme të zhvillimit të kurrikulës	25
5. Struktura e kurrikulës/fushat e të nxënit	30
5.1. Objektivat kryesore të fushave të të nxënit	31
6. Aftësitë dhe temat ndërkurrikulare	46
6.1. Aftësitë ndërkurrikulare	46
6.2. Tema ndërkurrikulare	53
7. Mësimdhënia dhe të nxënit e efektshëm	57
8. Vlerësimi	61

PJESA E DYTË

Çështje të zbatimit të kornizës kurrikulare.....	65
Fazat kryesore të procesit të zhvillimit të paketës kurrikulare.....	66
I. Dialogu dhe formulimi i politikës.....	66
II. Arsyeja e ndryshimit.....	67
III. Procesi i konsultimit.....	69
IV. Mbrojtja përpara autoriteteve arsimore.....	69
V. Hartimi i kurrikulës në nivel qendror.....	70
VI. Hartimi i kurrikulës në bazë shkolle.....	83
VII. Rishikimi i standardeve të mësuesit në përputhje me kërkesat e reja të kurrikulës.....	85

PJESA E PARË

KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

1. HYRJE

Kurrikula, në kuptimin e gjerë, është faktori më i rëndësishëm i procesit të arsimimit. Ajo përcakton se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit, cilat vlera duhen kultivuar tek ata, si duhet të aftësohen për bashkëjetesë dhe tolerancë, si mund të japin ndihmesën e tyre në mënyrë aktive për mirëqenie shoqërore dhe vetjake. Si e tillë, kurrikula është themeli mbi të cilin ngrihet procesi i arsimimit, si dhe thelbi i çdo procesi reformimi tërësor ose të pjesshëm të arsimit.

Zhvillimi dhe reformimi i kurrikulës së arsimit parauniversitar në vendin tonë bazohet në një sërë dokumentesh thelbësore, të cilat pasqyrojnë

politikat dhe strategjitë arsimore për të ardhmen. Ndër to, korniza kurrikulare përcakton të gjithë parametrat e nevojshëm për të garantuar zhvillimin dhe zbatimin e një reforme kurrikulare tërësore e cilësore.

Korniza kurrikulare përmbledh në vetvete argumentimin e nevojave për ndryshime kurrikulare, parimet e përgjithshme mbi të cilat mbështetet kurrikula dhe reformimi i saj, synimet e përgjithshme të kurrikulës, fushat kurrikulare dhe objektivat e tyre të përgjithshëm, drejtimet ndërkurrikulare, parimet e mësimdhënies dhe të nxënies efektiv, si dhe ato të vlerësimit.

Si e tillë, korniza kurrikulare:

- përbën dokumentin themelor të kurrikulës K-12 dhe udhërrëfyesin për hartimin e dokumenteve vijuese kurrikularë, si: plani mësimor, standardet e të nxënies dhe të arritjes, programet lëndore, tekstet e nxënësve e botime të tjera mbështetëse për mësuesit dhe për zbatimin e zhvillimin e kurrikulës në shkollë;
- përcakton, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e arsimit dhe gjithë të interesuarit, rezultatet e përgjithshme të të nxënies dhe ua bën ato të qarta nxënësve, mësuesve, prindërve e punonjësve të tjerë të institucioneve arsimore dhe publikut të gjerë.

Kurrikula u përgjigjet ndryshimeve shoqërore e ekonomike. Ajo ripërtërihet në bazë të ndryshimeve dhe sipas ligjeve të brendshme të zhvillimit të saj.

2. SISTEMI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR DHE NEVOJA PËR NDRYSHIME KURRIKULARE

Nevoja për zhvillimin dhe reformimin e kurrikulës

Ndryshimet që ndodhin vazhdimisht në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore, të ndërlidhura me ato që ndodhin në nivel rajonal dhe global, të para në kontekstin shkollor, kushtëzojnë drejtimit, përmbajtjen, ritmet, thellësinë dhe gjerësinë e zhvillimeve arsimore dhe veçanërisht të ndryshimeve kurrikulare.

Faktorët e mëposhtëm, aktualisht të pranishëm e veprues në realitetin shqiptar e global, shtrojnë nevojën e rishikimit të politikës arsimore si vijon:

a. Zhvillimi i një arsimit të orientuar nga vlera njerëzore e morale

Sistemi ynë arsimor ka detyrë të identifikojë, të transmetojë, të mbështesë e të krijojë ato vlera që

ndihmojnë në zhvillimin e plotë të personalitetit të individit si qytetar i Shqipërisë dhe i botës.

b. Interesat të larmishme të nxënësve

Sistemi ynë arsimor ka përgjegjësinë për të qenë vazhdimisht i vëmendshëm ndaj botës dhe interesave të nxënësve dhe për t'i mbajtur ato parasysht në zhvillimin, zbatimin dhe reformimin e çdo politike arsimore e kurrikulare.

c. Rritja e vazhdueshme e informacionit

Sistemi ynë arsimor duhet të përcaktojë se mbi ç'bazë do të zgjidhet përmbajtja e asaj që duhet të mësohet, si do të përcaktohet ajo që është e rëndësishme për nxënësin nga sasia aktuale e informacionit dhe si do të ndërtohen dhe do të strukturohen njohuritë e marra.

Shkolla duhet të drejtojë nxënësit drejt qëndrimeve gjithnjë e më kritike ndaj njohurive të fituara dhe zhvillimit të aftësive për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike.

d. Shoqëria shumëkulturore

Sistemi ynë arsimor përfshin si pjesë përbërëse e të rëndësishme të synimeve të arsimimit, përvetësimin e disa gjuhëve të huaja dhe edukimin ndërkulturor për komunikim e bashkëjetesë paqësore dhe të suksesshme në një shoqëri gjithnjë e më të larmishme.

e. Aftësimi profesional

Sistemi ynë arsimor duhet të mundësojë zhvillimin, përmes arsimit profesional, të kompetencave profesio-

nale të bazuara në njohuri, aftësi, shprehi dhe qëndrime të nevojshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin në nivele më të larta arsimimi dhe formimi profesional.

Sistemi ynë arsimor duhet të nxisë edhe në arsimin e përgjithshëm zhvillimin e moduleve profesionale, që synojnë të pajisin nxënësit me grupe aftësish profesionale, për t'u hapur atyre dyert e botës e të tregut të punës.

Sistemi ynë arsimor ka detyrë të zhvillojë aftësi dhe shprehi bazë të larmishme e të qëndrueshme, të cilat lehtësojnë përshtatjen e të rinjve me kërkesat në ndryshim të profesioneve të fushave të veprimtarisë shoqërore.

f. Të nxënit për sipërmarrje

Sistemi ynë arsimor duhet t'u mundësojë nxënësve që në fillimet e arsimimit të tyre, të nxënit për sipërmarrje, edukimin e punës së pavarur, të marrjes së përgjegjësiave për detyra që lidhen me të nxënit dhe jetën e tyre, si individë dhe anëtarë të shoqërisë ku jetojnë.

g. Prirjet decentralizuese

Sistemi ynë arsimor duhet të bëhet më i përgjegjshëm dhe më i aftë për të marrë përsipër zgjidhjen e problemeve arsimore që lindin në nivel vendor, si dhe përgatitjen e kapaciteteve për këtë proces.

h. Standardet bashkëkohore

Sistemi ynë arsimor duhet të mbajë parasysh prirjet europiane në fushën e unifikimit të standardeve

shkollore gjatë zhvillimit ose rishikimit të kurrikulës shkollore të arsimit parauniversitar.

i. Ndryshimet strukturore në arsimin parauniversitar

Aktualisht sistemi ynë arsimor është në procesin e konsolidimit të një reforme strukturore, që ka në thelb:

- kalimin e arsimit bazë nga tetë në nëntë vjet;
- zgjatjen e ciklit fillor nga pesë në gjashtë vjet;
- kalimin e arsimit të mesëm të lartë nga katër në tre vjet.

Këto ndryshime strukturore shoqërohen edhe me nevojën për përcaktimin e standardeve të të nxënësve sipas cikleve të reja të shkollimit dhe për një reformë kurrikulare në përshtatje me këto standarde.

Nevojat për zhvillimin dhe reformimin e kurrikulës kërkojnë edhe rishikimin, për qëllim përmirësimi, të elementeve përbërës të saj, të synimeve, të objektivave, të fushave e të integritit të tyre, të përshtatjes më të mirë me interesat e nxënësve që në arsimin bazë, të ngarkesës mësimore, të trajnimeve të mësuesve, të vlerësimit etj.

3. SISTEMI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR, SYNIMET DHE REZULATET E PRITSHME

Sistemi arsimor parauniversitar mbështetet në traditën pozitive të arsimit shqiptar, funksionon në zbatim dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e legjislacionin shqiptar në fuqi dhe zhvillohet në respekt të vlerave të përbashkëta të sistemeve arsimore bashkëkohore.

Sistemi ynë arsimor parauniversitar përbëhet nga:

- a) **Arsimi parashkollor**, që përfshin arsimimin e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, në kopshte ose 5-6 vjeç në klasa përgatitore.
- b) **Arsimi fillor**, që shtrihet nga klasa e parë në klasën e gjashtë.
- c) **Arsimi i mesëm i ulët**, që shtrihet nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë.
- d) **Arsimi i mesëm i lartë**, që përfshin klasën e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Në këtë nivel bëjnë pjesë gjimnazi, arsimi

i mesëm i orientuar dhe arsimi i mesëm profesional, i cili, në disa degë, shtrihet edhe në klasën e trembëdhjetë.

Sistemi ynë arsimor synon të formojë nxënës që të jenë të aftë të jetojnë dhe të kontribuojnë aktivisht në shoqërinë demokratike, të zotë të përballojnë e të përshkatan në një botë të larmishme e në ndryshim të pandërprerë në të gjitha fushat e jetës, të dijes dhe të punës.

Pikë e rëndësishme referimi për arsimin tonë parauniversitar janë edhe **kompetencat themelore europiane**:

1. komunikimi në gjuhën amtare;
2. komunikimi në gjuhë të huaja;
3. kompetenca matematikore dhe kompetencat bazë në shkencat dhe teknologjinë;
4. kompetenca digjitale;
5. kompetenca për të nxënë gjatë gjithë jetës;
6. kompetencat shoqërore dhe qytetare;
7. kompetenca e iniciativës dhe sipërmarrjes;
8. kompetenca e formimit kulturor dhe e shprehjes.

Përparësitë e reformës

Duke u bazuar në kërkesat e realitetit dhe në prirjet themelore të arsimit në rajon e në botë, reforma aktuale kurrikulare në vendin tonë veçon si përparësi themelore, afatgjata:

1. Zotërimin në nivel të lartë të gjuhës amtare.
2. Zotërimin në nivel të lartë të matematikës.
3. Zotërimin e dy gjuhëve të huaja.
4. Aftësimin në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.

Synimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar

Arsimi ynë parauniversitar merr përsipër të formojë nxënësin, që në mënyrë të përgjegjshme:

- respekton, mbron identitetin kombëtar dhe zhvillon trashëgiminë kulturore;
- zhvillon aspektin etik, intelektual, fizik, social dhe estetik të tij;
- mendon në mënyrë të pavarur, kritike e krijuese;
- ndjen kënaqësi nga procesi i të nxënës dhe është i motivuar për të marrë pjesë në punë të mëtejshme studimore;
- përshtatet me ndryshimet, ka vetëbesim e shpirt bashkëpunimi;

- mbron bindjen se drejtësia, paqja, harmonia, bashkëpunimi dhe respekti për të tjerët janë vlerat më të larta njerëzore;
- ofron ndihmesën e tij për mirëqenien, përparimin, lirinë e demokracinë;
- respekton traditat e popujve të tjerë;
- përmbush përgjegjësitë e tij për mbrojtjen e mjedisit;
- pasuron vazhdimisht njohuritë, aftësitë, shprehjet dhe qëndrimet e nevojshme që lehtësojnë punësimin dhe përparimin në nivele më të larta të formimit profesional.

Rezultatet e pritshme për nxënësin

a. Në përfundim të arsimit parashkollor, nxënësi:

- Kupton, njeh veten dhe të tjerët.
- Kupton dhe pranon ndryshueshmërinë e jetës, është tolerant dhe merr pjesë lehtësisht në veprimtari grupi.
- Dallon ndjenjat vetjake dhe të të tjerëve dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Përdor gjuhën shqipe për të shprehur ndjenjat dhe mendimet e tij.
- Zotëron shprehi të thjeshta komunikuese dhe artistike.
- Përdor njohuri të thjeshta në jetën e përditshme.

- Kujdeset në mënyrë të pavarur për higjienën vetjake dhe të mjedisit.

b. Në përfundim të **arsimit fillor**, nxënësi:

- Përdor drejt në jetën e përditshme gjuhën shqipe standarde, të shkruar dhe të folur.
- Komunikon në mënyrë të ndryshme ndjenjat, idetë e përvojat vetjake.
- Zotëron njohuri fillestare të një gjuhe të huaj.
- Përdor simbole e bën veprime matematikore për zgjidhjen e problemeve të thjeshta në jetën e përditshme.
- Përdor konceptet fillestare të kohës dhe të hapësirës për t'u orientuar në mjedis.
- Kërkon të drejtat e tij dhe respekton të drejtat e të tjerëve.
- Mban higjienën vetjake, njeh dhe shmang faktorët e dëmshëm për shëndetin e tij dhe të të tjerëve.
- Kujdeset për mbrojtjen e mjedisit në familje, shkollë e komunitet.
- Përdor mjete të thjeshta të komunikimit artistik.
- Zotëron dhe kontrollon funksionet trupore në veprimtaritë e lojërat e ndryshme fizike.

- Respekton veçoritë kulturore të individëve, grupeve e kombeve të tjera.
- Shfaq vlera të mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit në marrëdhënie me të tjerët.
- Zotëron njohuritë e aftësitë e domosdoshme për shkollimin në nivele më larta.

c. Në përfundim të arsimit të mesëm të ulët, nxënësi:

- Kupton, zhvillon e komunikon ide dhe informacione në gjuhën shqipe standarde.
- Lexon, shkruan, dëgjon e komunikon tekste të llojeve të ndryshme letrare, joletrare e mediatike, në përshtatje me qëllime dhe audiencë të caktuara.
- Lexon, shkruan, dëgjon e komunikon në një gjuhë të huaj.
- Zotëron njohuritë bazë të shkencave të natyrës dhe të shoqërisë dhe rëndësinë e vlerës së tyre praktike.
- Zotëron e përdor metoda e shprehje të përshtatshme për të jetuar, për të nxënë dhe për të punuar në shkollë, familje e komunitet.
- Kupton veten si pjesë të një grupi ose shoqërie dhe përshtatet me situatat e

ndryshme që krijohen në familje, shkollë e komunitet.

- Komunikon në mënyrë të efektshme, duke përdorur mjete dhe metoda të ndryshme komunikimi.
- Përdor metoda të ndryshme për zgjidhjen e problemeve dhe argumenton zgjedhjet e vendimmarrjet e tij.
- Dallon veçoritë e konteksteve gjeografike, kulturore e historike dhe i përdor ato në marrëdhëniet e jetës së përditshme.
- Vlerëson trashëgiminë kulturore të popullit shqiptar dhe respekton atë të kombeve të tjera.
- Përdor pajisjet e teknologjisë në shtëpi, në shkollë e komunitet.
- Gjen, përzgjedh, shkëmben dhe përdor informacion në veprimtaritë e tij dhe në komunikimin me të tjerët.
- Ndjen nevojën për t'u marrë me veprimtari të ndryshme fizike e sportive dhe zhvillon veprimtari të tilla me dëshirë.
- Ruan dhe zhvillon shëndetin vetjak dhe ndihmon aktivisht në ruajtjen e shëndetit të të tjerëve.
- Zbaton njohuritë dhe aftësitë e fituara në mënyrë krijuese e rrethana të ndryshme.

- Mbron të drejtat e tij dhe të të tjerëve.
- Ndërton marrëdhënie me të tjerët pa paragjykime, mbi bazën e respektit të ndërsjellë.
- Zotëron njohuritë e aftësitë e domosdoshme për shkollimin në nivele më larta.

d. Në përfundim të **arsimit të mesëm**, nxënësi:

- Kupton, zhvillon dhe komunikon ide dhe informacione në gjuhën shqipe standarde.
- Lexon, shkruan, dëgjon e komunikon tekste të llojeve të ndryshme letrare, jo letrare e mediatike, në përshtatje me qëllime dhe audienca të caktuara.
- Lexon, shkruan, dëgjon e komunikon ide dhe informacione të paktën në dy gjuhë të huaja.
- Analizon faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë, shfaq të kuptuarit e botës si një bashkësi sistemesh të ndërvarura.
- Merr, analizon, vlerëson dhe përdor informacione nga burime të ndryshme.
- Bashkëvepron me të tjerët në grup, për të arritur objektiva të nxëni individuale dhe kolektive.

- Njeh mirë mjedisin shoqëror, natyror e kulturor në të cilin vepron dhe përdor aftësitë dhe shkathhtësitë e nevojshme, për të punuar e bashkëpunuar me të tjerët.
- Zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për një mënyrë jetese të shëndetshme e të sigurt.
- Njeh ligjet bazë të shkencave të natyrës dhe kupton vlerën praktike të njohurive të fituara.
- Kupton dhe vlerëson botën fizike, biologjike e teknologjike dhe merr vendime të përgjegjshme e të argumentuara për çështje që lidhen me to.
- Kupton dhe vlerëson kontekstet e larmishme shoqërore, kulturore, gjuhësore, politike, gjeografike dhe historike dhe merr pjesë si qytetar aktiv dhe i mirinformuar për to.
- Shpreh idetë e qëndrimet e tij përmes veprimtarive të veta krijuese dhe interesin e respektin e tij për punën artistike, kulturore e intelektuale të të tjerëve.
- Shfaq qëndrime të pavarura e kritike ndaj veprave dhe veprimtarive letrare e artistike dhe shprehet në mënyrë krijuese për ato.
- Kupton dhe zbaton teknika të ndryshme analitike e krijuese për të zgjidhur

problemet në funksion të plotësisimit të nevojave dhe gjetjes së mundësive konkrete.

- Kupton, interpreton dhe zbaton koncepte që lidhen me modelet matematikore e hapësinore, me strukturat dhe lidhjet ndërmjet tyre.
- Përzgjedh e përdor në mënyrë krijuese e të suksesshme dhe me vetëbesim teknologjitë e ndryshme.
- Zotëron aftësinë për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Njeh mjedisin e punës dhe zotëron dijet dhe aftësitë për të vlerësuar mundësitë e ndryshme për karrierë.
- Zhvillon sistem vetjak vlerash, duke u bazuar në të kuptuarit e çështjeve morale dhe shpirtërore.
- Zotëron aftësitë e nevojshme, jo vetëm për mirëqenie ekonomike përmes integritit në botën e punës, por edhe për sfida të ardhshme globale.
- Bën zgjedhje të mençura për një jetë të shëndetshme dhe të sigurtë dhe mban qëndrime të vendosura në mbrojtje të shëndetit e të mjedisit në shkallë lokale, kombëtare e më gjerë.

- Ndjen nevojën për t'u marrë me veprimtari të ndryshme fizike e sportive dhe zhvillon veprimtari të tilla me dëshirë.
- Zotëron njohuritë e aftësitë e domosdoshme për shkollim në nivele më të larta.

e. Në përfundim të **arsimit të mesëm profesional**, përveç aftësive të mësipërme, nxënësi:

- Zotëron kompetencat profesionale të bazuara në njohuri, aftësi, shprehi dhe qëndrime, të nevojshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin e tij në nivele më të larta të formimit profesional e të përgjithshëm.
- Zotëron aftësitë e nevojshme për të dalë në tregun e punës në përshtatje me interesat e tij.
- Zotëron aftësitë për të nxënë gjatë gjithë jetës, për të ecur në një hap me risitë teknologjike me të cilat do të ndeshet në vendin e punës.
- Zotëron njohuri, aftësi e shprehi të përgjithshme e të larmishme profesionale, që lehtësojnë kalimin e tij në fusha e profesione të ndryshme.
- Njeh mjedisin e punës dhe zotëron dijet dhe aftësitë për të vlerësuar mundësitë e ndryshme për karrierë.
- Zotëron aftësitë e nevojshme jo vetëm për mirëqenie ekonomike përmes integritit

në botën e punës, por edhe për sfida të ardhshme globale.

- Sillet në mënyrë të sigurtë, për vete e për të tjerët, në vendin e punës e në jetë.
- Bën zgjedhje të mençura për një jetë të shëndetshme dhe mban qëndrime të vendosura në mbrojtje të shëndetit e të mjedisit, në vendin e punës e më gjerë.
- Respekton të gjitha llojet e punëve dhe përvojat e të tjerëve.

4. PARIMET TË PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS

Organizimi dhe mirëfunksionimi i kurrikulës kërkon që zhvillimi i saj të drejtohet nga disa pikënisje parimore. Parimet kryesore sipas të cilave zhvillohet kurrikula janë si vijon:

- **Konceptim i gjerë i kurrikulës**

Kurrikula, në kuptimin e gjerë, është një harmonizim dinamik i kurrikulës së synuar që përfshihet në dokumentet e shkruara dhe i asaj që zhvillohet e zbatohet realisht në praktikën e shkollës. Koncepti tërësor i kurrikulës duhet të përfshijë përmbajtjen, mjedisin e të nxënit, metodat e mësimdhënies, burimet e të nxënit, praktikat e vlerësimit dhe mënyrat e shumta të bashkëveprimit ndërmjet nxënësve, mësuesve dhe komunitetit.

- **Gjithëpërfshirja**

Kurrikula duhet të njohë, të pranojë, të respektojë dhe t'u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të

nxënësve, pavarësisht nga prejardhja ose veçoritë e tyre. Ky parim synon të ndërtojë një kurrikulë që të krijojë mundësi të barabarta për sukses vetjak për çdo nxënës.

- **Përshtatshmëria**

Kurrikula duhet të jetë e zhdërvjellët, për të mundësuar përshtatjen e saj me nevojat e veçanta të individit ose grupeve të nxënësve në nivel shkolle. Ajo duhet të jetë e përshtatshme edhe për nxënësit me nevoja dhe interesa të veçanta të nxëni.

- **Baraspesha dhe integrimi**

Kurrikula organizohet në fusha të nxëni që kanë në themel ndarjen dhe integrimin real të fushave të dijes. Si e tillë, kurrikula duhet të sigurojë njëherësh baraspeshën ndërmjet njohurive e aftësive të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre.

Shkalla, thellësia dhe forma e integritit kushtëzohen nga veçoritë e fushave, lëndëve, temave, aftësive, vlerave etj., të nevojshme për t'u integruar. Kjo do të thotë që, integrimi është një proces dinamik, që varet nga nevojat në ndryshim të përvetësimit të njohurive dhe aftësive dhe nga situatat e të nxënit.

- **Vijimësia**

Nxënësit zhvillohen, nxënë në ritme dhe mënyra të ndryshme, duke i ndërtuar dijet e tyre mbi bazën

e njohurive dhe të përvojës vetjake paraprake. Për këtë arsye, kurrikula hartohet dhe zbatohet në harmoni me veçoritë kryesore të grup-moshave, në varësi të mundësisë dhe të gatishmërisë së fëmijëve për të nxënë ose për të përvetësuar aftësi të caktuara.

Në të njëjtën kohë, ajo ua bën të qartë nxënësve dhe prindërve të tyre drejtimin, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënësve në nivele të ndryshme arsimimi.

- **Bashkëpunimi dhe partneriteti**

Arsimi është përgjegjësi e përbashkët e nxënësve, mësuesve, prindërve, specialistëve të arsimit dhe e gjithë shoqërisë. Për këtë arsye, planifikimi, zhvillimi, zbatimi i kurrikulës dhe, mbi të gjitha, arritja e objektivave të synuar, kërkonjë bashkëpunim të përgjegjshëm të të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara.

- **Të nxënësve gjatë gjithë jetës**

Roli i arsimit është të përgatisë nxënësit për një botë që ndryshon shpejt dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Kurrikula duhet të mundësojë që nxënësit të jenë të zotë të vazhdojnë kërkimet e tyre për njohuri, aftësi e shprehje të reja, të përdorin metoda të larmishme të nxënësve, të cilat mundësojnë zhvillimin dhe përvetësimin e aftësive të ndryshme gjatë gjithë jetës.

- **Aftësimi për jetën dhe botën e punës**

Arsimi dhe e gjithë kurrikula që është në themel të tij, duhet t'i shërbejnë aftësimin të nxënësve për jetën, t'i pajisin ata me dije, aftësi, shprehje praktike e qëndrime të domosdoshme, për të përballuar me sukses nevojat e punësimit dhe sfidat e jetës së përditshme, për të siguruar një të nxënë të vazhdueshëm në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Shkolla duhet të orientojë zhvillimin e karrierës së nxënësve dhe t'i edukojë me ndjenjën e vetëbesimit, respektit për çdo lloj pune dhe profesioni.

- **Decentralizimi**

Decentralizimi në fushën e kurrikulës është parim i rëndësishëm i zhvillimit të saj, pasi:

- ndihmon përshtatjen më të mirë të kurrikulës së synuar dhe të zbatuar në nivel shkolle me nevojat e nxënësve;
- krijon më shumë mundësi për përditësimin e procesit të mësimdhënies;
- mundëson pasurimin e kurrikulës me lëndë dhe veprimtari të ndryshme, që e afrojnë atë më shumë me kërkesat e nxënësve dhe me kërkesat dhe veçoritë e zhvillimit dhe tregut rajonal të punës.

- **Standardet bashkëkohore**

Perspektiva e integritit në Bashkimin Europian kërkon që arsimi ynë parauniversitar të bëhet i



Sistemi arsimor parauniversitar, synimet dhe rezultatet e pritshme

krahasueshëm me cilësinë e standardeve europiane. Kurrikula e re, krahas kërkesave të shoqërisë shqiptare, duhet të mbajë parasysh edhe kërkesat e jetës e të punës në një Europë demokratike e në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

5. STRUKTURA E KURRIKULËS DHE FUSHAT E TË NXËNIT

Kurrikula organizohet sipas fushave të mëposhtme të të nxënit:

1. Gjuhë shqipe dhe letërsi
2. Gjuhë e huaj
3. Matematikë
4. Shkenca natyrore
5. Shkenca shoqërore
6. Edukim për sipërmarrjen
7. Arte
8. Edukim fizik dhe sporte
9. Teknologji

Numri i fushave të të nxënit mund të jetë i ndryshëm në cikle të ndryshme arsimore.

Në zbatim të filozofisë së kurrikulës dhe të parimeve të ndërtimit të saj, kurrikula ndahet në kurrikulë bërthamë dhe në kurrikulë me zgjedhje.

Kurrikula bërthamë është e përbashkët për të gjithë nxënësit.

Kurrikula me zgjedhje përvijohet sipas interesave, nevojave dhe aspiratave të nxënësve e të prindërve dhe në përputhje me mundësitë e shkollës. Ajo ndahet në kurrikulë me zgjedhje të detyruar dhe në kurrikulë me zgjedhje të lirë.

Pesha e kurrikulës me zgjedhje dhe hapësira e saj është e ndryshme për cikle të ndryshme arsimore dhe për klasa të ndryshme të të njëjtit cikël.

5.1 OBJEKTIVAT KRYESORE TË FUSHAVE TË TË NXËNIT

Fushat e të nxënit, më vete dhe në lidhje me njëra-tjetrën, synojnë zhvillimin e njohurive, të qëndrimeve dhe të aftësive të veçanta e të përgjithshme.

Ato janë një mënyrë e organizimit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve themelore për arsimimin e nxënësve dhe ofrojnë një strukturë organizimi të baraspeshuar e të integruar të synimeve dhe objektivave të të nxënit.

1. Fusha: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Gjuha shqipe dhe letërsia janë bazë për procesin e të mësuarit, të komunikimit, të formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe të lidhjeve njerëzore. Si të tilla, si një fushë të nxëni, gjuha shqipe dhe letërsia studiojnë artin e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit, duke u mbështetur në tekste letrare, joletrare dhe vizuale. Zhvillimi i interesit të nxënësve për gjuhën dhe letërsinë, dialogu, kuptimi e vlerësimi kritik i teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare, si produkte gjuhësore, janë boshte kryesore të kësaj fushe.

Synimet e fushës

Fusha e gjuhës shqipe dhe letërsisë synon që, gjatë arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të zhvillojnë aftësitë për të lexuar, për të shkruar, për të folur dhe për të dëgjuar në mënyrë aktive tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe të kultivojnë nëpërmjet tyre mendimin kritik e krijues;
- të gjejnë, të krahasojnë, të analizojnë, të interpretojnë e të vlerësojnë informacione nga tekste të ndryshme, t'i përshtatin ato me qëllime dhe audienca të caktuara, si dhe t'i integrojnë ato me përvojat e tyre;

- të demonstrojnë kompetencat e tyre gjuhësore e letrare, për të marrë pjesë efektivisht në jetën e përditshme;
- të zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e të lexuarit për t'u bërë përdorues të pavarur dhe aktivë të gjuhës gjatë gjithë jetës;
- të çmojnë dhe vlerësojnë letërsinë kombëtare e botërore, duke respektuar e mbrojtur identitetin kombëtar dhe duke vlerësuar larminë kulturore, nëpërmjet studimit të veprave të shkrimtarëve, përfaqësues të periudhave të ndryshme të letërsisë shqiptare dhe botërore.

2. Fusha: Gjuhë e huaj

Të mësuarit e gjuhëve të huaja ka për synim zhvillimin gjuhësor, intelektual dhe kulturor të nxënësve, në mënyrë që ata të jenë të aftë të përballen me situatat e jetës së përditshme dhe të nxënit gjatë gjithë jetës.

Të mësuarit e gjuhëve të huaja u ofron nxënësve mundësinë të njohin dhe të kuptojnë mënyrën e të menduarit dhe të sjelljes së popujve të tjerë, për të lehtësuar komunikimin ndërmjet njerëzve, në një botë të larmishme e me shumë kultura.

Mësimi i gjuhës së huaj mbështetet në filozofinë dhe në udhëzimet e Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët dhe në dokumente të

tjerë kurrikularë të arsimit parauniversitar në Shqipëri.

Synimet e fushës

Fusha e gjuhëve të huaja synon që, gjatë viteve të arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të ndërgjegjësohen për nevojën e përdorimit të gjuhës së huaj;
- të zhvillojnë aftësitë e tyre njohëse, gjuhësore, ndërkulturore dhe emocionale;
- të përdorin gjuhën e huaj si mjet komunikimi;
- të krijojnë shprehjet për një punë fillestare të pavarur dhe të përdorin strategji të të mësuarit, që e bëjnë atë sa më krijues;
- të thellojnë njohuritë gjuhësore, për të marrë dhe për të shprehur informacion, përmes të cilave ata të zgjerojnë njohuritë për botën dhe formohen nga ana intelektuale.

3. Fusha: Matematikë

Fusha e matematikës synon të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë

dhe strukturat matematikore, si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë llogaritëse e të zgjidhjes së problemit në jetën reale.

Përmes kurrikulës së matematikës, nxënësit aftësohen dhe fitojnë besim në përdorimin e numrave dhe kuptimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre, përsosin aftësitë e matjes, të ndërtimit e të interpretimit hapësinor. Ata mësojnë të grumbullojnë, të organizojnë dhe të interpretojnë të dhëna, të gjykojnë për mundësinë e ndodhjes së ngjarjeve e dukurive, të modelojnë matematikisht situata të ndryshme praktike, të mendojnë në mënyrë abstrakte, të zbulojnë e të kuptojnë lidhjet e matematikës me jetën reale.

Në fushën e matematikës formohen gatishmëria për veprimtari intelektuale, aftësia e përqendrimit, aftësia krijuese dhe fantazia.

Synimet e fushës

Fusha e matematikës synon që, gjatë arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të zotërojnë dijet, aftësitë konkrete matematike dhe vlerat përkatëse për zbatime të njohurive të kësaj fushe në situata praktike të jetës së përditshme dhe asaj social-ekonomike, për studimin e disiplinave të përfaqëruara, për vazhdimin e studimeve dhe për punësimin në profesione të ndryshme;

- të formojnë shkathtësi të arsytimit logjik-matematik;
- të jenë të aftë të merren në mënyrë krijuese me marrëdhëniet abstrakte dhe me gjuhën simbolike, me kuptimin e lidhjeve ndërmjet gjuhës së folur e të shkruar, si dhe me kuptimin e lidhjeve ndërmjet botës e modeleve të saj;
- të vlerësojnë matematikën në tërësi si formë e përshkrimit, si metodë e njohjes së realitetit dhe si pjesë e kulturës njerëzore e progresit shoqëror.

4. Fusha: Shkenca natyrore

Shkencat natyrore u ofrojnë nxënësve mundësi të njohin, të kuptojnë dhe të hulumtojnë natyrën, botën inorganike, organike dhe njeriun.

Shkencat natyrore përfaqësojnë fushën kurrikulare, e cila u ofron nxënësve mundësi të zhvillojnë të kuptuarit e koncepteve, të teorive dhe të ligjeve themelore të zhvillimit të natyrës.

Synimet e fushës

Fusha e shkencave natyrore synon që, gjatë arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të kuptojnë dukuritë natyrore, ligjet e zhvillimit të natyrës, të testojnë arritjet shkencore përmes vëzhgimeve, matjeve e eksperimenteve, si dhe t'i përdorin ato në jetën e përditshme;
- të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të domosdoshme për të kontribuar në përmirësimin e nivelit teknologjik në shoqëri e të cilësisë së jetës;
- të zhvillojnë aftësi hulumtuese, duke ndjekur hapat e metodologjisë së kërkimit shkencor;
- të vlerësojnë përparimin shkencor në kuadrin e përpjekjeve të njerëzimit për të vënë natyrën në shërbimin e tij afatgjatë.

5. Fusha: Shkenca shoqërore

Shkencat shoqërore kanë si qëllim kryesor të zhvillojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe prirjet, që janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike. Shkencat shoqërore i ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë njohuri dhe qëndrime, të cilat ofrojnë mënyra dhe këndvështrime të ndryshme të trajtimit të realitetit.

Ato janë të hapura ndaj ndryshimeve, duke lëvruar metoda të reja integruese për të zgjidhur çështjet themelore të shoqërisë njerëzore. Shkencat shoqërore kanë për detyrë të ndihmojnë nxënësit të

zhvillojnë aftësinë e tyre për të marrë vendime të arsyeshme për të mirën e përbashkët.

Synimet e fushës

Fusha e shkencave shoqërore synon që, gjatë arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të përftojnë njohuritë bazë në disiplinat kryesore të shkencave shoqërore, si: historia, gjeografia, qytetaria, sociologjia, ekonomia, psikologjia, filozofia etj dhe aftësitë për t'i zbatuar ato në jetën e tyre të përditshme;
- të fitojnë bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve politike, ekonomike, shoqërore e kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to, përmes studimit të gjithë përvojës njerëzore;
- të kuptojnë konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe të zbatojnë këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri;
- të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë gjeografike, si: vendndodhjen, vendet, ndërveprimin njerëzor/mjedisor, lëvizjet dhe rajonet;
- të fitojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për të marrë pjesë në mënyrë të përgjegjshme në zhvillimet e vazhdueshme demokratike;

- të zbatojnë kuptimin e ndikimit të ndërvepimit njerëzor dhe larmisë kulturore në shoqëri;
- të marrin vendime, duke u bazuar në ligjësitë ekonomike.

6. Fusha: Edukim për sipërmarrjen

Zhvillimi i karrierës është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës. Ai fillon në familje, zhvillohet gjatë periudhës së shkollimit, gjatë përvojave të punës dhe njehsohet me aftësinë e individit për të marrë vendime për të ardhmen e tij.

Edukimi për karrierën i aftëson nxënësit për të zbuluar mundësitë e karrierës së tyre, për të vlerësuar veten, interesat e prirjet individuale, për të marrë vendime për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin, për të qenë pjesëtarë funksionalë të shoqërisë.

Synimet e fushës

Fusha e Edukimit për sipërmarrjen synon që, gjatë arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të zotërojnë aftësi për të planifikuar dhe për të marrë vendime në mënyrë të pavarur për sipërmarrje personale që lidhen me

karrierën, në përputhje me interesat, prirjet dhe cilësitë vetjake;

- të përgatiten në përdorimin e strategjive të suksesshme për arritjen e objektivave të ardhshëm të karrierës;
- të zotërojnë aftësi për të analizuar tregun e punës, profesionet dhe kualifikimet profesionale;
- të zotërojnë njohuri dhe aftësi për të zbatuar elemente të sipërmarrjes në projekte konkrete.

7. Fusha: Arte

Artet janë pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e kurrikulës, e cila lidhet ngushtë me zhvillimin intelektual, social, kulturor dhe afektiv të nxënësve.

Fusha e arteve përmbledh disiplinat art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër. Ajo ndihmon në krijimin e lidhjeve të individëve me përvoja të ndryshme artistike. Duke krijuar, duke shprehur dhe duke komunikuar përmes arteve, kjo fushë u siguron nxënësve kuptimin mbi veten dhe mbi botën.

Gjithashtu nëpërmjet trajtimit historik të vlerave artistike kombëtare ajo ndihmon në zhvillimin e vetëdijes kombëtare të nxënësve. Përmes kësaj

fushe, nxënësve u krijohen hapësirat për të identifikuar aftësitë individuale artistike dhe mundësitë për profesionin e tyre të ardhshëm.

Synimet e fushës

Fusha e arteve synon që, gjatë viteve të arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të kuptojnë dhe të analizojnë të bukurën në art, duke përdorur elementet estetike dhe kritike në vlerësimin e një vepre muzikore, skenike apo figurative;
- të komunikojnë përmes fushës së artit, duke përdorur mjete, teknika dhe materiale të përshtatshme për realizimin e një vepre artistike;
- të vlerësojnë veprat e artit shqiptar dhe botëror, të krijuara në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike;
- të zhvillojnë vetëdijen kombëtare nëpërmjet trajtimit historik të vlerave artistike kombëtare
- të identifikojnë aftësitë individuale artistike, duke i parë ato si një mundësi për profesionin e tyre të ardhshëm.

8. Fusha: Edukim fizik dhe sporte

Përmes edukimit fizik dhe sporteve, nxënësve u krijohet mundësia për të marrë pjesë në një shumëllojshmëri veprimtarish fizike, individualisht dhe në grup. Roli i kësaj fushe është të edukojë te nxënësit një mënyrë jetese të shëndetshme dhe aktive.

Duke i bindur ata mbi rolin e kësaj fushe në mirëqenien fizike, mendore dhe shoqërore, ajo zhvillon tek nxënësit dëshirën dhe vullnetin për veprimtaritë fizike. Veprimtaritë fizike dhe sportive përmirësojnë gjendjen shëndetësore, zhvillojnë aftësitë motore dhe theksojnë rëndësinë e ushtrimit sistematik, disiplinës, konkurrencës dhe veprimtarisë në grup.

Kjo fushë ndihmon nxënësit për të vlerësuar sportin si alternativë karriere në të ardhmen.

Synimet e fushës

Fusha e edukimit fizik dhe e sporteve synon që, gjatë arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre mbi lloje të ndryshme veprimtarish fizike dhe sportesh;
- të krijojnë një model jete aktive që siguron mirëqenie mendore, trupore e sociale dhe parandalon sëmundjet;

- të vlerësojnë gjendjen e tyre fizike dhe të vendosin objektiva për veten;
- të ndërmarrin veprime të sigurta dhe me përgjegjësi si individualisht, ashtu edhe në grup;
- të përshkruajnë zhvillimin teknologjik në funksion të edukimit fizik dhe sportit.

9. Fusha: Teknologji

Teknologjia është një formë e veçantë e veprimtarisë praktike e krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre, duke përdorur materialet dhe proceset e duhura, në përgjigje të nevojave, interesave dhe mundësive të tyre.

Nxënësit vlerësojnë dhe kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake për çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nëpërmjet arsimit teknologjik, nxënësit zbatojnë njohuritë dhe aftësitë, përvojat dhe burimet teknologjike në funksion të plotësimit të nevojave për ndryshim të individëve, të shoqërisë dhe mjedisit, duke forcuar e rritur vetëbesimin dhe shpirtin e iniciativës.

Nxënësit, përmes TIK-ut, aftësohen për të kërkuar,

për të zgjeruar, për të përpunuar informacione dhe për t'i vënë ato shërbim të punës dhe të jetës së përditshme, duke e bërë përdorimin e TIK- ut një aftësi krijuese dhe produktive në të gjitha aspektet e shoqërisë.

Teknologjia duhet të ofrojë mundësinë që nxënësit të fitojnë njohuri e aftësi fillestare në fusha të caktuara të veprimtarisë shoqërore e profesionale, që do t'ua hapin atyre më shumë dyert për botën e punës dhe për të vazhduar arsimimin e tyre në kurse ose arsim postsekondar.

Synimet e fushës

Fusha e Teknologjisë synon që, gjatë arsimit parauniversitar, nxënësit:

- të zbulojnë dhe të vlerësojnë ndikimin e teknologjisë në ekonomi, në shoqëri e në mjedis, në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen;
- të integrojnë njohuri dhe shkathtësi/shprehi për gjetjen e zgjidhjeve për probleme të thjeshta teknologjike;
- të vlerësojnë dhe të zbatojnë në praktikë njohuritë e nevojshme për çështjet e shëndetit dhe të sigurisë;
- të përdorin shumëllojshmëri të mediave dhe teknologjive, si edhe programe kompjuterike në shërbim të të nxënësve dhe krijimit të produkteve;

Struktura e kurrikulës dhe fushat e të nxënit

- të përdorin mjete të ndryshme teknologjike për të zhvilluar komunikimin, si dhe të menduarin kritik dhe krijues
- të pajisen me aftësitë e nevojshme për të thelluar njohuritë e tyre në këtë fushë;
- të pajisen me grupe të ndryshme aftësish që lidhen me veprimtari e profesione të ndryshme;
- të komunikojnë dhe të shprehin aftësitë e tyre krijuese, duke përdorur larmi formash shprehëse, si: fjalë, grafikë, modele etj.
- të integrojnë njohuri dhe shkathtësi/ shprehi për zgjidhjen e problemeve të thjeshta teknologjike.

6. AFTËSI DHE TEMA NDËRKURRIKULARE

Përgatitja e nxënësve për jetën dhe punën në të ardhmen kërkon që kurrikula t'u mundësojë fëmijëve e të rinjve të fitojnë disa aftësi bazë, që ata të zhvillohen si manaxherë të vetvetes, mendimtarë kritikë e krijues, të pavarur, problemzgjdhës, pjesëmarrës aktivë në grup dhe komunikues të mirë.

6.1. AFTËSITË NDËRKURRIKULARE

Kurrikula përcjell njëherazi disa aftësi, të cilat përfshijnë fushat dhe lëndët e saj. Kurrikula e arsimit parauniversitar synon të zhvillojë këto aftësi ndërkurrikulare:

a. Aftësia e komunikimit

Komunikimi, në kuptimin e dhënies dhe marrjes së informacionit, të ideve dhe të imazheve, si dhe

të transmetimit të ndjenjave, zhvillohet te nxënësit në secilën nga fushat e të nxënit. Kurrikula duhet t'i japë mundësinë secilit nxënës të bëhet i aftë të komunikojë qartë, saktë e kuptueshëm në mënyra të larmishme. Ajo duhet të synojë të aftësojë nxënësit që, sipas standardeve e niveleve arsimore:

- të transmetojnë me gojë dhe me shkrim, në përshtatje me situatat e ndryshme, informacione, ide, ndjenja dhe pamje në mënyrë të saktë, duke përdorur një fjalor gjithnjë e më të pasur;
- të njohin, të analizojnë dhe të interpretojnë tekste dhe forma të ndryshme komunikimi;
- të shprehin opinionet e tyre, të diskutojnë, të arsyetojnë dhe të angazhohen në debate;
- të dialogojnë, duke dëgjuar me vëmendje, duke nxitur e respektuar opinionet e të tjerëve.

b. Aftësia e të menduarit kritik

Aftësia e të menduarit kritik mundëson rritjen e shkallës së arsyetimit të argumentuar e të pavarur të nxënësve. Të menduarit kritik përfshin grumbullimin, përzgjedhjen e informacionit të nevojshëm, vlerësimin dhe arritjen e një përfundimi. Kurrikula synon të aftësojë nxënësit:

- të përdorin metoda të larmishme për identifikimin e strukturave të informacionit dhe të ideve;
- të mbështesin me argumente dhe fakte bindjet, përgjithësimet, dhe përfundimet e tyre;
- të mbajnë ose të krijojnë qëndrime të pavarura, të mbështetura me argumente ndaj gjykimeve dhe qëndrimeve të tjerëve;
- të shpjegojnë lidhjet ndërmjet së tërës dhe pjesëve të saj përbërëse, të dallojnë faktet nga interpretimet e të zhvillojnë linja arsyetimi bazuar në fakte/përfundime/parashikime;
- të jenë të aftë të marrin në shqyrtim e të korrigjojnë veten.

c. Aftësia e të menduarit krijues

Të menduarit krijues mundëson zbulimin e ideve të reja, krijimin e lidhjeve origjinale mes tyre dhe gjetjen e një larmie zgjidhjesh për situatat problemore.

Në të gjitha fushat e të nxënit, kurrikula ua jep mundësinë nxënësve të shfaqin origjinalitetin e tyre dhe të zhvillojnë prirjet e veta krijuese. Ajo synon të aftësojë nxënësit:

- të shprehin, nëpërmjet një larmie formash,

anët origjinale të personalitetit të tyre në shkollë, komunitet dhe punë;

- të pranojnë dhe të kërkojnë ide e rrugëzgjdhje të reja;
- të mirëpresin idetë dhe përvojat e reja të të tjerëve;
- të parashikojnë mundësitë për dështime e gabime dhe të gjejë zgjidhje për shmangien e tyre.

d. Aftësia e zgjidhjes së problemit

Aftësia e zgjidhjes së problemit u jep nxënësve mundësinë të sfidojnë, të zgjidhin dhe të manaxhojnë situatat e larmishme problemore të jetës së përditshme, duke u mundësuar njëkohësisht atyre zbulimin dhe hetimin e botës shkencore dhe teknologjike. Ajo shërben si bazë e të nxënësve të mëtejshëm dhe e bën individin të jetë aktiv dhe efektiv si në jetën personale, ashtu dhe në atë shoqërore. Në këtë drejtim, kurrikula e arsimit parauniversitar synon të aftësojë nxënësit:

- të analizojnë situatat problemore dhe të hartojnë plane ndërvepruese për zgjidhjen e tyre;
- të ndjekin dhe të vlerësojnë ecurinë e etapave të zgjidhjes së problemit;
- të bëjnë parashikime, të ngrenë hipoteza, të argumentojnë në mënyrë bindëse metodat

e përdorura të kërkimit dhe përfundimet e arritura;

- të kërkojnë, të gjejnë zgjidhje të ndryshme dhe t'i vlerësojnë ato në përputhje me dobinë dhe zbatueshmërinë;
- të vlerësojnë rrugëzgjdhjet me qëllim përmirësimin e tyre;
- të komunikojnë zgjidhjen tek të tjerët.

e. Aftësia e përdorimit të matematikës

Në të gjitha fushat e të nxënit, kurrikula u jep mundësinë nxënësve të përdorin njohuri dhe aftësi matematike. Ajo synon që çdo nxënës të bëhet i aftë të përdorë në fushat e tjera të të nxënit:

- Njohuritë dhe shprehjet matematike.
- Metodën matematike.
- Arsyetimin matematik.

f. Aftësia e përdorimit dhe e përpunimit të informacionit dhe të komunikimit

Përdorimi dhe përpunimi i informacionit ndihmojnë nxënësit të bëhen më të efektshëm në një mjedis të tejmbushur me informacion. Për këtë arsye, kurrikula e arsimit parauniversitar synon të aftësojë nxënësit:

- të sigurojnë dhe të përzgjedhin informacione nga burime të ndryshme e në përshtatje me qëllimin e tyre;
- të përdorin teknika dhe strategji të formave të ndryshme, me qëllim përfitimin, analizën, përpunimin, dhe interpretimin e informacioneve;
- të vlerësojnë seriozitetin dhe besueshmërinë e burimeve, duke përdorur kritere, si: autorësia, lidhja, aktualiteti, përvoja e autorit;
- të paraqesin informacione, duke shfrytëzuar larmi teknologjish informacioni dhe komunikimi (p.sh., poërpoin, video klip, aparat fotografik, digjital).

g. Aftësia e të punuarit në grup

Nxënësi duhet të përfitojë nga kurrikula aftësinë për të punuar në grup me të tjerët, në mjedise e rrethana të ndryshme dhe me synime të qarta.

Kjo aftësi nënkupton që ai të jetë në gjendje të përcjellë idetë dhe nevojat brenda grupit, duke respektuar pikëpamjet e ndryshme të anëtarëve të tjerë, të arrijë në marrëveshje, të marrë përsipër përgjegjësitë si anëtar i grupit ose si drejtues i tij, të ndihmojë të tjerët të ndihen të përfshirë në grup dhe të motivojë grupin për të tejkaluar vështirësitë. Kurrikula synon të aftësojë nxënësit:

- të punojnë me të tjerët në grup, në mjedise e kontekste të ndryshme, me synime dhe qëllime të përcaktuara;
- të përcjellin idetë dhe nevojat brenda grupit, duke respektuar pikëpamjet e ndryshme të anëtarëve të tij;
- të arrijnë marrëveshje për planet e veprimt, për të respektuar afatet dhe planet e pranuar;
- të marrin përsipër përgjegjësitë e të qenit pjesë e grupit si anëtar ose si drejtues i tij;
- të ndihmojnë të tjerët të ndihen të përfshirë në grup dhe të motivojnë grupin për të kaluar vështirësitë.

h. Aftësia e qëndrimit etik e social

Shkolla synon të edukojë vlera dhe parime të përgjithshme të pranuar nga shoqëria, të cilat lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve në veçanti, me respektimin dhe me zhvillimin e vlerave kombëtare, me mbrojtjen e mjedisit në të gjithë larminë e tij, me zhvillimin e qëndrueshëm etj. Në të gjitha fushat e të nxënës, kurrikula u jep mundësinë nxënësve që të mbajnë qëndrim etik e social ndaj ngjarjeve, dukurive dhe pikëpamjeve e sjelljeve të ndryshme në shoqëri. Ajo synon të aftësojë nxënësit:

Aftësi dhe tema ndërkurrikulare

- të vlerësojnë sjelljet, veprimet dhe qëndrimet e tyre dhe të tjerëve nga pikëpamja e së mirës të përbashkët të komunitetit, të vendit e më gjerë;
- të vlerësojnë dukuritë, ngjarjet, qëndrimet dhe veprimet e të tjerëve në të shkuarën dhe në të tashmen, nga pikëpamja e dobisë shoqërore për komunitetin, vendin, rajonin dhe më gjerë;
- të jenë pjesëmarrës aktivë në veprimtaritë, të cilat synojnë përmirësime në shkallë komuniteti, vendi, rajoni dhe më gjerë.

6.2. TEMA NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Trajtimi i tyre synon përvetësimin e disa njohurive specifike, kultivimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara te nxënësit. Të tilla tema janë: identiteti kombëtar, qytetaria aktive dhe sipërmarrja, siguria dhe shëndeti mendor e fizik, identiteti kulturor dhe njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, teknologjia, media dhe shoqëria, pjesëmarrja në komunitet, edukimi global etj.

Temat ndërkurrikulare integrojnë fushat kurrikulare të të nxënës, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Temat ndërkurrikulare përcaktohen sipas politikave kombëtare afatmesme e afatgjata dhe konkretizohen e zbërthehen në nivel vendor e në bazë shkolle. Ndër to përmendim:

Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

Arsimi duhet t'u krijojë nxënësve mundësitë për të formuar identitetin e tyre kombëtar e kulturor nëpërmjet gjithë kurrikulës. Ai u jep mundësi atyre të kuptojnë zhvillimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, si dhe të krijojnë një këndvështrim pozitiv e pranues të përvojave, kulturave dhe mënyrave të jetesës së minoriteteve etnike, kulturore dhe grupeve shoqërore.

Atdhedashuria do të edukohet natyrshëm vetëm nëpërmjet njohjes së thellë të jetës, gjeografisë, historisë, gjuhës e letërsisë shqipe, si dhe veprimtarive shkollore që zbulojnë, mbrojnë dhe zhvillojnë trashëgiminë kulturore e historike shqiptare.

Qytetaria aktive dhe sipërmarrja

Qytetaria aktive dhe sipërmarrja nënkuptojnë përgatitjen e nxënësve si qytetarë të sotmes dhe të së ardhmes, që respektojnë të drejtat e tyre dhe të të tjerëve, të aftë për të menduar dhe për të vepruar në mënyrë konstruktive për mirëqenien vetjake, shoqërore dhe ekonomike, në një vend demokratik, brenda komunitetit ndërkombëtar.

Shëndeti mendor e fizik dhe siguria

Edukimi i të rinjve për të qenë të aftë të zgjedhin mënyra jetese të shëndetshme e të sigurta është kërkesë dhe përgjegjësi sa individuale, aq edhe shoqërore.

Për këtë arsye, çdo veprimtari kurrikulare duhet t'i shërbejë aftësisë të nxënësve për të fituar sjellje pozitive shëndetësore, për të parandaluar sëmundjet dhe rreziqet, për të vlerësuar shëndetin, për të ndihmuar të tjerët në situata të jashtëzakonshme etj.

Zhvillimi i qëndrueshëm

Qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm është të garantojë mundësitë e brezave të sotëm dhe të ardhshëm për një jetë më të mirë.

Kurrikula duhet të edukojë të nxënësit aftësinë dhe prirjen për të ndjekur një mënyrë jetese dhe për të ndërmarrë veprime për zhvillimin e qëndrueshëm.

Nxënësit duhet të aftësohen të zbulojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, që kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin; problemet që lidhen me rritjen e popullsisë, varfërinë dhe urinë; burimet e ripërtërishme të energjisë dhe kursimin e saj; ndërmarrjet e biznesit dhe teknologjitë që kënaqin parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Teknologjia, shoqëria dhe media

Zhvillimi i teknologjisë bazohet në nevojën e njerëzve për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Kurrikula duhet të zhvillojë te nxënësit aftësitë e përdorimit të TIK-ut, aftësitë e përdorimit të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja.

Vend kryesor në sigurimin e kulturës së komunikimit te nxënësit ka aftësimi i tyre për të përdorur median për përftimin e informacionit dhe të shprehjes së tij.

Edukimi për median nënkupton zhvillimin e aftësive verbale, pamore, dëgjuese, teknike dhe sociale të nxënësve.

7. MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E EFEKTSHËM

Metodologjitë e mësimdhënies në arsimin parauniversitar përfshijnë përdorimin e stileve dhe të modeleve të mësimdhënies, të cilat sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe shfrytëzimin e informacionit, duke nxitur përgjegjshmërinë vetjake, iniciativën, reflektimin, pavarësinë e gjykimit, vetëvlerësimin, bashkëpunimin dhe barazinë.

Metodat e mësimdhënies marrin parasysh dhe plotësojnë nevojat e të nxënësve.

Përmbushja e objektivave të kurrikulës kërkon edhe realizimin e një mësimdhënieje dhe të nxënësve të efektshëm, që:

- **bazohet në bindjen se çdo nxënës mund të jetë i suksesshëm.** Mësimdhënia e efektshme siguron kushtet e të nxënësve për të gjithë nxënësit.
- **bazohet në njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve dhe e planifikon të nxënësve mbi bazën e tyre.** Njohuritë paraprake të nxënësve janë kusht jo vetëm për përvetësimin

e dijeve të reja, por edhe për realizimin e një mësimdhënieje ndërvepruese.

- **planifikohet për objektiva të të nxënit.** Mësuesi saktëson objektivat e arritjeve të nxënësve të tij mbi bazën e synimeve dhe standardeve, të cilat renditen si një zinxhir logjik në kurrikul. Hallkat e këtij zinxhiri janë synimet e sistemit arsimor, synimet e kurrikulës, ato të linjave ndërkurrikulare, të fushës së të nxënit, të lëndës, standardet e fushës dhe objektivat e programit lëndor.
- **aftëson të nxënit gjatë gjithë jetës.** Aftësia për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese, aftësia për të përballuar situata problemore e çështje kundërshtuese, për të manaxhuar informacionin, shprehitë e punës së pavarur individuale ose në grup, vetëvlerësimi etj., janë thelbësore për të siguruar të nxënit gjatë gjithë jetës.
- **aftëson nxënësit të përdorin njohuritë.** Aftësimi i nxënësve për të përdorur njohuritë dhe shprehitë e fituara duhet të jetë synimi kryesor i procesit të mësimdhënies dhe të nxënit në shkollë.
- **siguron partneritetin mësues-nxënës në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit.** Ky partneritet rrit motivimin e nxënësve dhe krijon klimën dhe kushtet e domosdoshme për shfrytëzimin e njohurive dhe përvojave të nxënësve dhe mësuesve.

- **përfshin të nxënit në grupe të vogla**, si një mundësi e mirë për të krijuar marrëdhënie pozitive ndërmjet nxënësve dhe qëndrime më dashamirëse ndaj lëndës e mësuesve. Si e tillë, ajo rrit vetëvlerësimin e nxënësve, nxit formimin e aftësive shoqërore dhe siguron arritje dhe motivim më të lartë në procesin e të nxënit.
- **mbështetet në situata reale ose të ngjashme me realitetin**. Ajo mundëson përzgjedhjen dhe përdorimin e situatave që hasen në jetën e përditshme, që nga jeta personale, familjare, shoqërore e deri tek e vendit, rajonit e më gjerë.
- **bazohet në parimin e integritit lëndor**, i cili pasqyron integrimin e dijeve njerëzore, të cilat kurrikula e zbatuar merr përsipër t'i zhvillojë. Në këtë mënyrë, mësimdhënia efektive kultivon edhe të menduarit ndërlëndor.
- **përshkohet nga parimi i përzgjedhjes**. Ajo vë në përdorim forma të larmishme të vepërimitarive mësimore, si: përmbajtje të veçanta kurrikulare, detyra të diferencuara, projekte, burime informacioni etj., që sigurojnë realizimin e këtij parimi.
- **zhvillohet mbi bazën e burimeve të shumëllojshme të informacionit**. Qëmtimi në burime alternative informacioni, përveç tekstit shkollor, është kusht i rëndësishëm për përvetësimin më të mirë të koncepteve dhe metodave dhe aftëson nxënësit për të nxënë

gjatë gjithë jetës, për të përzgjedhur informacionet në mënyrë kritike.

- **mbështetet në TIK.** Të nxënit elektronik (i mbështetur apo i lehtësuar nga TIK-u) luan rol të rëndësishëm në metodat e mësimdhënies. Shkollat duhet të eksplorojnë jo vetëm mundësitë e përdorimit të TIK-ut për të mbështetur mënyrat e mësimdhënies, por edhe hapësirat e tij, për të krijuar mënyra të reja e të ndryshme të nxëni.
- **përfshin sistematikisht nxënësit në eksperimente e vëzhgime,** për njohjen jo vetëm të natyrës, por edhe të shoqërisë.

Mësuesi është aktori kryesor i suksesit të mësimdhënies. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i tij mbetet kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve të synuara. Për këtë arsye, kurrikula, në mënyrë të veçantë ajo e arsimit bazë, kërkon ndryshimin e formimit fillestar të mësuesve, përmes rinovimit të kurrikulës së shkollave të larta e universitare dhe të sistemit të formimit të mësuesve.

8. VLERËSIMI

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit dhe të nxjerrë në pah rezultatet e tij. Praktikrat e vlerësimit kanë ndikim vendimtar në procesin e të nxënit dhe të mësimdhënies.

Çështje të tilla, si: çfarë të dhënash duhet të mbledhim për arritjet e nxënësve, si do t'i mbledhim dhe si do t'i interpretojmë ato, janë dhe duhet të jenë objekt debati në të gjithë komunitetin shkollor.

Mësuesit dhe nxënësit e ngrënë punën e tyre për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e të nxënit pikërisht duke u bazuar në cilësinë e informacionit që sigurohet nga këto gjykime. Kjo rrit edhe besueshmërinë e vlerësimeve të mësuesve te prindërit, kolegët dhe komuniteti.

Një vlerësim cilësor dhe i paanshëm bazohet në kritere të vlefshme, transparente dhe të zbatueshme.

Ky vlerësim i shërben përmirësimit të të nxënit, atëherë kur procesi ka karakter edukativ dhe motivues dhe mbështetet në kritere, si:

Vlefshmëria

Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm për idetë, proceset, rezultatet dhe vlerat që priten të ngjizen te nxënësit gjatë procesit të arsimit të tyre në nivele të ndryshme.

Nxënësit dhe mësuesit priren të përqendrojnë përpjekjet e tyre në dijet dhe aftësitë që vlerësohen, pasi në to vihen re edhe ndryshimet që shpesh janë objekt vlerësimi.

Për këtë arsye, proceset e vlerësimit duhet të trajtojnë të gjithë gamën e gjerë të objektivave dhe rezultateve të pritshme.

Kriteri arsimor

Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit në rritjen e cilësisë së të nxënit. Që të luajë këtë rol, vlerësimi duhet:

- të ketë vlerë arsimore në vetvete dhe të jetë pjesë përbërëse e gjithë procesit të të nxënit;
- të sigurojë informacion të vlefshëm dhe të aftësojë nxënësit të identifikojnë boshllëqet në njohuritë e tyre dhe pasaktësitë në procesin e të menduarit;

- të planifikohet në mënyrë të tillë që të nxisë përdorimin e strategjive afatgjata dhe të efektshme të të nxënit;
- të nxisë të nxënit e pavarur, duke bërë të mundur që nxënësit të marrin përsipër përgjegjësitë për vetëvlerësim.

Transparenca

Nxënësit kanë të drejtë dhe nevojë të njihen me kriteret me të cilat do të vlerësohen. Kjo garanton paanshmërinë e vlerësimit dhe ndihmon të nxënit.

Kriteret e qarta dhe të hapura ndihmojnë gjykimet profesionale, sigurojnë që vendimet të mund të shqyrtohen nga të gjithë dhe të jenë të qëndrueshme.

Paanshmëria

Vlerësimi duhet të jetë i paanshëm për të gjithë nxënësit dhe të mos jetë diskriminues.

Vlerësimi i paanshëm nënkupton vlerësimin e një objektivi, duke marrë parasysh karakteristikat dhe rrethanat e çdo nxënësi.

Këto karakteristika mund të përfshijnë: gjininë, etninë, gjuhën, racën, rrethanat ekonomike e shoqërore, vendndodhjen, si dhe personalitetin, talentin, aftësitë e kufizuara etj.

Vlerësimi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj këtyre ndryshimeve, në mënyrë që nxënësit të mos vihen në situata më pak ose më shumë të favorshme për të treguar arritjet e tyre.

Vlerësim tërësor

Gjykimet për përparimin e nxënësve duhet të bazohen në lloje dhe burime të ndryshme informacioni.

Informacioni i marrë nga vlerësimi duhet të tregojë në mënyrë të besueshme, nëse nxënësi është në gjendje të realizojë atë çfarë përshkruhet në objektiva.

Integrimi i llojeve dhe burimeve të ndryshme të të dhënave të mbledhura gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe në situata të ndryshme është kusht i domosdoshëm për të siguruar gjykime të qëndrueshme dhe të paanshme për arritjet e nxënësve.

PJESA E DYTË

ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË HARTIMIT DHE TË ZBATIMIT TË PAKETËS KURRIKULARE

Qëllimi i kësaj pjese është të udhëzojë hartuesit e kurrikulës në lidhje me procedurat dhe detyrat e aktorëve, të përfshirë në hartimin e kurrikulës, si dhe mënyrën e përmbushjes së këtyre detyrave. Ajo shtjellon se çfarë gjykohet e nevojshme të bëhet për hartimin dhe zbatimin e paketës, për rishikimin e kornizës kurrikulare dhe për hartimin, përmirësimin ose reformimin e kurrikulës të marrë në kuptimn e saj të gjerë.

Për këtë qëllim, këtu parashtrohen arsyet e rishikimit të kurrikulës, duke shtjelluar si synimet e herëpashershme të politikave arsimore për përmirësimin e cilësisë së kurrikulës, ashtu edhe kërkesën e vazhdueshme për përshtatjen e

kurrikulës kombëtare me prirjet e reja botërore. Po ashtu, në këtë pjesë, udhëzohen hartuesit e dokumenteve të paketës kurrikulare çfarë duhet të mbajnë parasysh për përmbushjen e kërkesave të rishikimit të kurrikulës.

Cilat janë fazat kryesore të procesit të zhvillimit ose të rishikimit të kurrikulës?

FAZAT KRYESORE TË PROCESIT TË ZHVILLIMIT TË PAKETËS KURRIKULARE

I. DIALOGU DHE FORMULIMI I POLITIKËS

Dialogu i politikës është procesi i formulimit të politikës publike për kurrikulën, përmes konsultimit me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit. Këto politika ndërtojnë themelet e punës së hartuesve të kurrikulës.

Hartuesi i politikës për ndryshimin e kurrikulës, paraprakisht duhet:

- të përzgjedhë çështjet që do të modelojnë ndryshimet në kurrikul dhe në sistemin arsimor, pra përcakton arsyet e ndryshimit;
- të përcaktojë kriteret për të përzgjedhur aktorët e ligjshëm në procesin e hartimit të kurrikulës, si dhe mënyrën e përfshirjes së tyre në procesin e konsultimit;

Çështje të përgjithshme të hartimit dhe të zbatimit të paketës kurrikulare

- të vendosë se cilët do të jenë pjesëmarrësit ose aktorët që duhet të përfshihen në procesin e reformimit dhe të ndryshimit të kurrikulës;
- të përcaktojë mënyrën e mbrojtjes së politikës kurrikulare përpara autoriteteve arsimore;
- të përcaktojë një listë të problemeve dhe të konflikteve të mundshme që mund të lindin gjatë formulimit dhe zbatimit të ndryshimeve të kurrikulës;
- të përzgjedhë zgjidhje alternative të problemeve ose të konflikteve të mundshme që mund të lindin gjatë formulimit dhe zbatimit të ndryshimeve kurrikulare.

II. ARSYEJA E NDRYSHIMIT

Hartuesi i politikës për ndryshimin e kurrikulës duhet të përcaktojë, paraprakisht, arsyet e përgjithshme për të cilat mund të ndryshojë kurrikula, të tilla si:

- zhvillimi i një arsimi të orientuar nga vlera njerëzore e morale;
- zhvillimi i qytetarëve të shëndetshëm, të përgjegjshëm dhe të aftë;
- ruajtja e traditave kombëtare ose vendore, vlerësimi dhe respektimi i larmisë kulturore në epokën e globalizimit;

- ruajtja e qëndrueshmërisë shoqërore, e identitetit dhe e kohezionit kombëtar;
- rindërtimi shoqëror, ekonomik dhe qytetar;
- sigurimi i rritjes ekonomike dhe përmirësimi i standardit të jetesës së popullsisë;
- pakësimi i pabarazive shoqërore dhe ekonomike dhe trajtimi i shqetësimeve që lidhen me drejtësinë shoqërore.
- Rritja e konkurrencës ndërkombëtare dhe e integritit global.

Bazuar në sa më sipër, hartuesi i politikës për ndryshimin e kurrikulës duhet:

- të analizojë realitetin ekonomik, shoqëror dhe kulturor shqiptar;
- të identifikojë dhe të analizojë historinë, pikat e forta dhe të dobëta të kurrikulës dhe të sistemit arsimor ekzistues;
- të identifikojë rolet, funksionet dhe interesat e aktorëve, të grupeve dhe të institucioneve të ndryshme që janë të përfshirë, ose janë të interesuar për ndryshime në kurrikul;
- të përcaktojë arsyet themelore për ndryshimet e kurrikulës në vend.

III. PROCESI I KONSULTIMIT

Hartuesi i politikës që lidhet me ndryshimin e kurrikulës duhet:

- të identifikojë grupet brenda sektorit të arsimit dhe të komunitetit më të gjerë, të cilët, në një shkallë të caktuar, janë përgjegjës ose të interesuar për kurrikulën;
- të qartësojë rolet e aktorëve kryesorë për zhvillimin e saj;
- të parashikojë reagimet kundërshtuese të përligjura ose jo, që mund të ndikojnë negativisht në ritmin e ndryshimit;
- të ndërtojë strategjinë e këshillimit me të gjithë aktorët e arsimit, në përputhje me natyrën e interesave dhe të përvojës së tyre;
- të zhvillojë dialogun me të gjithë aktorët brenda agjencive që janë përgjegjëse për zhvillimin e ndryshimeve në kurrikul dhe jashtë tyre.

IV. MBROJTJA PËRPARA AUTORITETEVE ARSIMORE

Hartuesi i politikës për ndryshimin e kurrikulës duhet të ndërtojë platformën e ndryshimeve kurrikulare për ta paraqitur përpara vendimarrësve.

Platforma përfshin çështje të tilla si:

- Idetë dhe vlerat themelore të vendimit për ndryshime kurrikulare.
- Problemi/et që zgjidh.
- Pasojat e mundshme të zbatimit ose të moszbatimit të çdo vendimi.
- Kosto financiare e çdo vendimi.
- Metodologjia e ndryshimit të kurrikulës.
- Rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë.

V. HARTIMI I KURRIKULËS NË NIVEL QENDROR

Procesi i zhvillimit të një kurrikule përfshin hartimin e paketës së plotës kurrikulare në të cilën bëjnë pjesë:

1. Korniza kurrikulare
2. Standardet e të nxëniet dhe të arritjes
3. Plani mësimor
4. Programet lëndore

1. Korniza kurrikulare

Korniza kurrikulare është dokumenti kurrikular bazë. Në kornizën kurrikulare duhet të paraqiten parimet dhe qëllimet e përgjithshme të kurrikulës,

fushat e të nxënit dhe lëndët përkatëse, rezultatet e pritshme të të nxënit për çdo nivel të arsimit parauniversitar dhe drejtimet ndërkurrikulare. Për këtë arsye, hartuesit e Kornizës kurrikulare *duhet të kujdesen që ajo:*

- të jetë një marrëveshje shoqërore që përcakton dhe shpreh qartë përparësitë kombëtare në fushën e arsimit dhe aspiratat për të ardhmen;
- të jetë një dokument që vendos parametrat për zhvillimin e dokumenteve të tjerë kurrikularë;
- të shprehë qartë qëllimet e shtetit për arsimin;
- të përcaktojë standardet e domosdoshme për përmbajtjen e arsimit, për kualifikimin e mësuesve, për burimet arsimore dhe materialet e të nxënit, për metodologjinë e mësimdhënies, për menaxhimin dhe vlerësimin e arritjeve.

2. Standardet e të nxënit dhe të arritjeve

2.1 Standardet e të nxënit

Standardet përbëjnë një sistem kërkesash ose parametrash të pranuar si normë shtetërore për arsimin në sektorë të ndryshëm. Ai i përgjigjet pyetjes: “Çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë të aftë të bëjnë nxënësit në fund të një cikli shkollimi?”

Standardi është një kompromis shoqëror, i cili krijon një marrëdhënie të caktuar ndërmjet shtetit dhe shoqërisë. Marrëdhënia është e bazuar në realizimin e politikës në fushën e arsimit dhe përmban në vetvete pranimin dhe zbatimin e detyrimit reciprok.

Standardet njësojnë pikat e referencës për zhvillimin dhe vlerësimin e kurrikulës dhe të gjithë sistemit arsimor, si dhe të marrëdhënieve të tij me shtetin e shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Për këtë arsye hartuesit e standardeve duhet të kujdesen që ato:

- të formulohen si detajim ose konkretizim i synimeve të fushave kurrikulare dhe i aftësive ndërlëndore, të shpallura në kornizën kurrikulare;
- të jenë në përputhje me prioritetet e kohës dhe perspektivat e mundshme afatshkurtra dhe afatmesme të shkollës dhe të realitetit;
- të reflektojnë dhe të mbajnë parasysh tiparet themelore të sistemit të arsimit;
- të lidhen me çështjet dhe problemet aktuale të vendit;
- të mbajnë parasysh pritjet themelore e të qëndrueshme të arsimit në botë e veçanërisht, në rajon;
- të jenë të vlefshme e të besueshme;
- të jenë të zbatueshme;

Çështje të përgjithshme të hartimit dhe të zbatimit të paketës kurrikulare

- të krijojnë mundësinë e krahasimit;
- të japin mundësi përdorimi;
- të mundësojnë gjykimin dhe diagnostikimin e progresit në arsim;
- të përmbajnë mundësitë e përmirësimit dhe të ndryshimit.

Standardet të organizohen në **fusha ose linja kryesore**. Kjo zgjidhje krijon:

- fleksibilitet në arritjen e standardeve;
- hapësirat e domosdoshme për trajtimin e problemeve ekzistuese dhe të reja, që mund të përfshihen në to, sipas niveleve dhe viteve.

Standardet duhe të njihen dhe të përdoren nga të gjithë vendimarrësit, aktorët dhe të interesuarit e tjerë të arsimit. Duhet të bëhet e mundur që ato të njihen dhe të përdoren:

Nga vendimarrësit në fushën e arsimit:

- për të parashikuar dhe projektuar ndryshimet në arsim;
- për të rishikuar dhe vlerësuar kurrikulën ekzistuese shtetërore;
- për të hartuar kornizën kurrikulare.

Nga pushteti lokal dhe shkollat:

- për të qenë bashkautorë në hartimin e kurrikulës dhe të programeve lëndore, në kuadrin e detajimeve dhe plotësimeve të tyre, sipas veçorive lokale;
- për të rishikuar dhe vlerësuar programet lëndore dhe për të paravlerësuar veprimtaritë shkollore në përgjithësi;
- për të ofruar ide dhe alternativa zgjidhjesh për procesin e të mësuarit dhe të vlerësimit.

Nga mësuesit:

- për të përcaktuar synimet dhe objektivat e orës së mësimit, të temës (kapitullit) ose të lëndës;
- për të vlerësuar praktikat e të mësuarit në shkollë e jashtë saj;
- për të zhvilluar ide për procesin e të mësuarit dhe të vlerësimit.

Nga prindërit dhe anëtarët e komunitetit:

- për të kuptuar ndihmesën e lëndëve në realizimin e qëllimeve të përgjithshme të shkollimit;
- për të vlerësuar cilësinë e edukimit në shkollë e në nivel lokal;
- për të gjykuar zhvillimin e fëmijëve të tyre në fushën përkatëse të njohurive, shkathtësive e shprehive.

Nga trajnuesit:

- për t'i njohur studentët që përgatiten për mësues dhe mësuesit në shërbim me planifikimin mësimor, që ka në bazë standardet;
- për të planifikuar, drejtuar, zhvilluar dhe vlerësuar veprimtaritë për trajnimin e studentëve dhe të mësuesve në shërbim.

2.2 Standardet e arritjeve

Standardet e arritjeve janë nivelet e pritura ose të dallueshme të aftësive të nxënësve në kuadrin e vlerësimit të një detyre, të dhënë në bazë të standardeve të të nxënësve.

Hartimi i modelit të standardeve të arritjes do të krijojë mundësinë e përcaktimit real të cilësisë së kërkuar të sistemit arsimor, të monitorimit, verifikimit dhe vlerësimit të tij nga shoqëria dhe shteti; do të krijojë dhe do të sigurojë sistemin e referimit për ndryshimet graduale afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata në arsim; do të rrisë shkallën e vlefshmërisë dhe përdorimit të rezultateve të vlerësimit të sistemit arsimor.

Përvoja e deritanishme, pranon dy metoda ose pikënisje për hartimin e standardeve të arritjes: metodën relative dhe metodën absolute.

1. Metoda relative mbështetet në strategjinë e vlerësimit që i referohet një vlere që shërben si

normë krahasimi. Për shembull, arritjet e një shkolle, në një vit të dhënë, përdoren si normë me të cilën krahasohen arritjet në vitet në vijim. Kjo normë përdoret si pikë referimi për vlerësimet e mëtejshme. Në bazë të kësaj strategjie edhe nivelet e arritjeve të nxënësve interpretohen duke u krahasuar me arritjet e një grupi tjetër nxënësish që pranojnë si grup normë.

Kjo metodë, megjithëse është e shpejtë, ka dizavantazhet e mëposhtme:

- Ajo të çon në kritere të vendosura në mënyrë arbitrare.
- Ndryshimet në arritje ndërmjet nxënësve, mund të duken shumë të vogla ose shumë të mëdha.
- Krijon vlerësime fiktive.
- Pavarësisht se cilat janë nivelet e referimit, gjithmonë do të ketë mësues dhe nxënës që do t'i vlerësojnë ato shumë të larta (tepër ambicioze) dhe shumë të ulta (të papërfillshme).

2. Metoda absolute mbështetet në strategjinë e vlerësimit në bazë të kritereve të përcaktuara (standardeve) dhe interpreton shkallën në të cilën nxënësit kanë përvetësuar këtë standard të paracaktuar.

Interpretimi i arritjeve të nxënësve mbi bazën e kësaj metode, nuk varet nga arritjet e nxënësve të tjerë.

Çështje të përgjithshme të hartimit dhe të zbatimit të paketës kurrikulare

Metoda absolute e përdorur në procesin e hartimit të standardeve të arritjes mundëson që nivelet e arritjes:

- të hartohen në nivel kombëtar, nga ekspertë lëndorë;
- të jenë të unifikuara për të gjithë;
- të njihen paraprakisht nga të gjithë;
- të gëzojnë miratimin në nivel kombëtar;
- të mos bazohen në matjen e asaj që nxënësit janë të aftë aktualisht të bëjnë etj.

Meqë e tërë kurrikula jonë bazohet në standarde të miratuara në nivel kombëtar, metoda absolute të jetë baza për hartimin e modelit të standardeve të arritjes, pra edhe të vlerësimit të nxënësve.

Standardet e arritjes zakonisht gjenden në tre nivele, pa llogaritur nivelin pakalues:

1. Niveli bazë
2. Niveli mesatar
3. Niveli i lartë

Specialistët e kurrikulës duhet të përcaktojnë, sa më qartë, karakteristikat e çdo niveli, në çdo lëndë, në mënyrë që të ofrojnë kritere të njësuara për vlerësimin e njohurive, të shkathtësive e shprehive të nxënësve, dhe kritere të hollësishme për vlerësimin e nivelit të realizimit të objektivave.

3. Plani mësimor

Plani mësimor është një dokument zyrtar i rëndësishëm i politikës arsimore. Në planin mësimor përcaktohet lista e lëndëve/fushave të detyrueshme dhe orët javore përkatëse për secilën klasë. Hartuesit e planit mësimor *duhet të sigurojnë* që plani mësimor:

- të mundësojë realizimin e parimeve dhe synimeve arsimore të përshkruara në kornizën kurrikulare;
- të ruajë ekuilibrin ndërmjet prirjes tradicionale dhe risive rajonale dhe/ose botërore;
- të sigurojë koherencën kurrikulare vertikale e horizontale;
- të përcjellë në mënyrë graduale ndryshimet nga viti në vit;
- të sigurojë, njëherazi, integritetin dhe integrimin e lëndëve etj.

4. Programet lëndore

Programet lëndore duhet të jenë në harmoni të plotë me të gjithë dokumentet bazë të paketës kurrikulare, që përcaktojnë kurrikulën kombëtare dhe me parimet mbi të cilat ajo është ndërtuar.

Për këtë arsye, hartuesit e programeve lëndore duhet të mbajnë mirë parasysh parimet e mëposhtme:

Programi lëndor përmbush parimet e të nxënit të përcaktuara në kornizën kurrikulare.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- të mundësojë aftësimin e nxënësit për t'u përfshirë më shumë në procesin e të nxënit, në marrjen e përgjegjësi për vete dhe shoqërinë dhe për të vazhduar të nxënit e tij të mëtejshëm;
- të mundësojë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet themelore, të cilat të gjithë nxënësit kanë të drejtë t'i fitojnë;
- të bazohet në standardet e të nxënit që mundësojnë vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe i ndihmon ata të planifikojnë të nxënit e tyre në të ardhmen;
- t'u japë mundësi mësuesve dhe shkollave të marrin vendime për të rritur në vazhdimësi mundësinë e të nxënit.

Programi lëndor duhet të përvijojë praktikat kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- të marrë parasysh zhvillimet më të fundit lidhur me fushat e dijes dhe ato lëndore;
- të përcaktojë nivelet e duhura (dhe të barasvlershme me botën ose rajonin) të

shkollimit, mbi bazën e studimeve krahasuese të kurrikulës kombëtare dhe asaj ndërkombëtare.

Programi lëndor duhet të sigurojë koherencën vertikale dhe atë horizontale të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- të marrë parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që zotërohen nga nxënësi për të cilin hartohet kurrikula (e ardhshme);
- të përshkruajë si do të mbështetet në njohuritë paraprake të nxënësve.

Programi lëndor duhet të sigurojë lidhjen e qartë mes qëllimeve, objektivave, rezultateve dhe përmbajtjes së të nxënit.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- të përmbajë objektiva që ndihmojnë në zhvillimin dhe organizimin e rezultateve të pritshme dhe të përmbajtjes së lëndës;
- të garantojë lidhjen ndërmjet objektivave dhe përmbajtjes së lëndës;
- të shpjegojë qartë natyrën, fushën dhe strukturën e përmbajtjes së lëndës.

Programi lëndor duhet të shtjellojë qartë se çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit për të arritur objektivat e lëndës.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- të përmbajë objektiva dhe përmbajtje të përcaktuara në përputhje me standardet e nivelit përkatës;
- të shprehë qartë objektivat dhe përmbajtjen e lëndës;
- të përcaktojë një përmbajtje lëndore që është e rëndësishme dhe e domosdoshme për të gjithë nxënësit;
- të përcaktojë rrugët që mundësojnë zgjerimin dhe thellimin e të nxënit të nxënësve;
- të integrojë përmbajtjen e duhur ndër-lëndore;
- të përmbajë shkallën e duhur të detajimit të objektivave dhe të përmbajtjes për të mundësuar vlerësimin dhe raportimin e arritjeve të nxënësve;
- të përmbajë objektiva dhe përmbajtje që realisht mund të realizohen dhe të trajtohen në kohën e përcaktuar.

Programi lëndor duhet të shtjellojë qartë rrugët për vlerësimin e arritjeve të nxënësve që burojnë nga objektivat e programit.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- të sugjerojë mënyra vlerësimi që dëshmojnë se arritjet e nxënësve mund të maten;
- të mundësojë vlerësimin e nxënësve duke u bazuar në standarde;
- të sigurojë praktika vlerësimi që pasqyrojnë edhe synimet e fushave ose të lëndëve.

Programi lëndor duhet të sigurojë marrëdhëniet ndërmjet përmbajtjes së lëndës me atë të lëndëve të tjera.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- merr parasysh përmbajtjen e lëndëve të tjera dhe mbivendosjet e mundshme të tyre;
- tregon rrugët se si përmbajtja e lëndës të mund të plotësojë atë të lëndëve të tjera.

Programi lëndor duhet të përmbushë kërkesat aktuale dhe t'u paraprijë kërkesave të ardhshme për lëndën.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- të mundësojë këshilla për të ardhmen.

Programi lëndor duhet të jetë i realizueshëm në kohën dhe me burimet e parashikuara për këtë qëllim.

Specialisti i kurrikulës të sigurojë që programi lëndor:

- realizohet në kohën e parashikuar për të;
- të përcaktojë kërkesat për cilësinë e mësuesit dhe të burimeve të tjera të nevojshme për realizimin e tij sa më cilësor.

VI. HARTIMI I KURRIKULËS NË BAZË SHKOLLE

Jo e gjithë kurrikula hartohet në nivel qendror. Në varësi të shkallës së decentralizimit të politikës arsimore, paralelisht me vendimmarrjen në fusha të tjera si ato politike, ekonomike, shoqërore, një pjesë e kurrikulës i besohet shkollës.

Hartuesi i politikës për ndryshimin e kurrikulës ndodhet përballë sfidës që:

- të garantohet cilësia e kurrikulës, pavarësisht nga niveli në të cilën ajo hartohet;
- synimet dhe përparësitë kombëtare në fushën e arsimit dhe të kurrikulës, të realizohen në mënyrë të vazhdueshme, pavarësisht nga niveli në të cilin hartohet dhe zbatohet kurrikula.

Kur vendos për barazpeshën ndërmjet kurrikulës qendrore dhe asaj në bazë shkolle, hartuesi i

politikës që lidhet me ndryshimin e kurrikulës të sigurojë që:

- zhvillimi i kurrikulës në bazë shkolle të mos çënojë drejtimin themelor të kurrikulës kombëtare;
- hartimi i kurrikulës në bazë shkolle të sigurojë, në të njëjtën kohë, përputhshmëri-në me standardet qendrore;
- hartimi i kurrikulës në bazë shkolle të paraprihet me trajnimin e hartuesve vendorë të kurrikulës;
- hartimi i kurrikulës në bazë shkolle të bëhet në kuadrin e një komunikimi të hapur, të qartë e të vazhdueshëm ndërmjet autoriteteve qendrore e vendore.

Zbatimi i kurrikulës në bazë shkolle duhet të sigurojë:

- përgjegjësi dhe aftësi shtesë në nivel vendor;
- qëndrimin mbështetës të mësuesve dhe mundësinë e marrjes së përgjegjësi-shtesë prej tyre në nivel vendor;
- krijimin e aftësive shtesë vendimarrëse dhe koordinuese në të gjitha nivelet e arsimit;
- burime të llojeve të ndryshme për të mundësuar zbatimin e decentralizimit.

VII. RISHIKIMI I STANDARDEVE TË MËSUESIT NË PËRPUTHJE ME KËRKESAT E REJA TË KURRIKULËS

Cilësia e mësuesit dhe e mësimit

Cilësia e mësimit, ka të bëjë me shkallën e kualifikimit dhe karakteristikave të mësuesit si profesionist, por, dhe mbi të gjitha, ka të bëjë me atë çfarë ai bën realisht në klasë, pra me nivelin e tij të mësimit.

Vendimmarrësit dhe specialistët e kualifikimit dhe të zhvillimit profesional të mësuesve duhet të përcaktojnë cilësinë e mësuesit dhe të mësimit për ta vënë atë në shërbim të realizimit të objektivave të kurrikulës dhe të synimeve të arsimit në përgjithësi. Për këtë qëllim ata duhet:

- të unifikojnë konceptin “cilësi e mësimit”, duke u bazuar në faktin që, “cilësia është shkalla në të cilën arrihen synimet dhe objektivat e vendosura”. Mbështetur në këtë kuptim, “mësim cilësor” është ajo që ndihmon të realizohen qëllimet e arsimit.
- të përcaktojnë standardet e mësuesit në varësi të kërkesave aktuale e perspektive të kurrikulës, në funksion të një të nxëni gjatë gjithë jetës;
- të përcaktojnë synimet, objektivat dhe përbajtjen e procesit të aftësisë të mësuesve për të qënë në lartësinë e realizimit të objektivave

të kurrikulës bashkëkohore dhe të rritjes së efektivitetit të mësimdhënies;

- të sigurojnë mbështetjen e mësuesve në të gjithë vendin me veprimtari për zhvillim profesional të vazhdueshëm, për të siguruar cilësinë e zbatimit të kurrikulës në të njëjtin nivel për klasë e nxënës;
- të përcaktojnë kriteret për vlerësimin e nivelit të arritjeve të mësuesve, veçanërisht në fushën e mësimdhënies dhe të përmbajtjes kurrikulare, që realizohet përmes procesit të kualifikimit;
- të hartojnë programe fleksibël të zhvillimit profesional të mësuesve, bazuar në standardet e kërkuara dhe në nevojat konkrete të grupeve të mësuesve.

